

Tyrbet fat apo fatkeqësi !?



Sepse adhurojnë, në vend të Allahut, atë që nuk mund t'u bëjë dëm as dobi,
dhe thonë: "Këta janë ndërmjetësuesit tanë te Allahu". .

Kuran, Junus 18





Komisioni i Përhershëm
për Kërkime Shkencore dhe Fetva

Tyrbet, fat apo fatkeqësi ?!

Mblodhi & Përktheu:

Firdeus Çorja





Titulli: Tyrbet, fat apo fatkegësi ?!

Autor: Komisioni i Përhershëm

Përkthyes: Firdeus Çorja

Redaktor letrar: Arjan Koçi

Botimi I

Janar 2014, Rabiul Euël 1435

www.firdeus.net



Për çdo vërejtje, mendim apo kontribut, ju lutem na
kontaktoni në adresën: info@firdeus.net

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

❁ Parathënie ¹

Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që pasojnë rrugën e tyre me devotshmëri deri në Ditën e Llogarisë.

Kur është në pikë të hallit, njeriu kërkon të gjejë rrugëdalje në çdo mënyrë. Fatkeqësisht shumë prej tyre kanë gjetur si rrugë të vetme për zgjidhjen e problemeve shkuarjen nëpër tyrbe apo siç u thonë ndryshe “*vende të mira*”, duke iu lutur dhe duke u kërkuar ndihmë të vdekurve, *evliave* ose *njerëzve të mirë*.

Është më se normale që njeriu të përplasat me peripeci, halle, probleme, sprova të ndryshme, por a është kjo mënyra ose zgjidhja e duhur për shërimin e këtyre problemeve?

¹ Përkthyesi.

Shpeshherë shohim e dëgjojmë se si persona të caktuar betohen në emrat e shehlerëve apo dervishëve, tashmë të vdekur. Kërkojnë ndihmë e shërim nga sëmundjet dhe mbrojtje prej tyre, shkojnë tek tyrbet dhe përulen para varreve të tyre, i puthin ata, fërkohen dhe rrotullohen tri herë rreth tyre. Disa të tjerë i vizitojnë ato me qëllim kërkimin e bereqetit. Në ditë të caktuara gjatë vitit theren kurbane pranë tyrbes ose *“vendit të mirë”*.

Njerëzit pushojnë aty (të sëmurëve u këshillohet që të flenë pak gjumë në afërsi të *“njeriut të mirë”*) dhe në fund hedhin pak dhé në një shishe. Atë e marrin nga varri ose u jep një shishe me ujë një zonjë që qëndron vazhdimisht aty apo siç thonë *“ujë për derman”*. Mund të merren edhe gurë, të cilët mbahen në portofol si fatsjellës. Duke mos harruar para se të largohen që të ndezin një qiri dhe të hedhin një sasi parash në sëndukun që ndodhet aty pranë.

Këto vepra që përmendëm a përrputhen dhe a kanë baza në fenë islame?

1. Betimi në emrat e shehlerëve, dervishëve apo tyrbeve;
2. Kërkimi i bereqetit tek tyrbet;
3. Kërkimi i ndihmës, shërimit të sëmundjeve dhe mbrojtjes tek tyrbet;

4. Puthja e varrit, fërkimi dhe rrotullimi rreth tij;
5. Therja e kurbaneve tek tyrbet;
6. Pirja e ujit dhe marrja e dheut për fat;
7. Shkuarja e gruas tek tyrbet (varret) me qëllim shtatzëninë².

Më poshtë do sqarojmë realitetin e këtyre zakoneve shumë të përhapura në trojet tona. Këto pyetje që u janë drejtuar dijetarëve në botën islame po i japim bashkë me përgjigjet e tyre.

✿ Devijimi i njerëzve ³

Allahu i krijoi krijesat që ta adhurojnë Atë dhe ua bëri të përshtatshme jetesën duke i furnizuar me të mirat e Tij. I Lartësuari thotë: **“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë Mua.”**⁴

Nëse një foshnjë do të lihej e lirë në natyrshmërinë e saj, ajo do ta njihte Allahun dhe do ta adhuronte Atë, një e të vetëm, pa i shoqëruar asgjë.

² Për të kërkuar fëmijë nga këto vende.

³ "Libri i Teuhidit", el Alameh Salih el Feuzan.

⁴ Kuran, Edh-Dharijat: 56-58.

Mirëpo janë shejtanët, prej njerëzve dhe xhinëve, që me zbukurimet dhe mashtrimet e tyre e largojnë nga kjo rrugë.

Teuhidi⁵ (monoteizmi) është i rrënjosur thellë në zemrën e njeriut, ndërsa shirku është pjesë e huaj. Allahu thotë: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”**⁶

Profeti ﷺ thotë: **“Të gjithë njerëzit lindin në natyrën e pastër, porse janë prindërit ata që e shndërrojnë atë në çifut, të krishterë apo mexhus (adhurues zjarri).”**⁷

Pra baza, thelbi tek njerëzit, është që ta pranojnë teuhidin, ta adhurojnë Allahun, një e të vetëm. Feja islame daton që nga Ademi (alejhi selam) dhe shumë breza me radhë pas tij e adhuruan Allahun, një e të vetëm, pa i shoqëruar askënd Atij, pra ishin në një fe të vetme.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Njerëzit ishin në një fe të vetme (në fenë e natyrshme islame) e (kur u përçanë) Allahu dërgoi (te ta) Profetë, përgëzues dhe tërheqës i vërejtjes.”**⁸

⁵ Teuhid do të thotë adhurim i Allahut një e të vetëm.

⁶ Kuran, Er-Rum: 30.

⁷ Buhariu, Muslimi.

⁸ Kuran, El-Bekare: 213.

Për herë të parë shirku dhe devijimi nga besimi i vërtetë u shfaq tek populli i Nuhut, i cili është Profeti i parë. **“Ne të frymëzuam ty (o Muhamed) me shpallje, ashtu siç frymëzuam me shpallje Nuhun dhe Profetët pas tij.”**⁹

Ibn Abasi ka thënë: *“Mes Ademit dhe Nuhut qenë dhjetë gjenerata, të gjitha në teuhid (monoteizëm), besim të pastër.”* Këtë e dëshmon fjala e Allahut: **“Të gjithë njerëzit kanë qenë të një feje të vetme, pastaj u përçanë.”**¹⁰

Shkak i dërgimit të Profetëve ishte përçarja dhe largimi i njerëzve nga feja e vërtetë.

Shirku dhe llojet e tij¹¹

Përkufizimi i shirkut është t'i bësh Allahut shok apo ortak në diçka që i përket vetëm Atij, siç janë: krijimi, furnizimi, zotërimi apo adhurimet e ndryshme, si: të bërit kurban, betimi, frika, dashuria, shpresa, namazi, agjërimi etj.

⁹ Kuran, En-Nisa: 163.

¹⁰ Kuran, Junus: 19.

¹¹ "Libri i Teuhidit", el Alameh Salih el Feuzan.

Shirku konsiderohet si mëkati më i madh për disa arsye:

1. Përngjan Krijuesin me krijesat në veçori që i përkasin vetëm Allahut;
2. Allahu nuk ia fal këtë mëkat atij që nuk pendohet;
3. Allahu ia ka ndaluar xhenetin politeistit dhe vendi i tij do jetë zjarri i përhershëm;
4. Shirku i fshin të gjitha punët e mira;
5. Shirku është mëkati më i madh;
6. Shirku tregon se Allahu është jo i plotë, ka mangësi.

Llojet e shirkut:

1. **Shirku i madh**, i cili të nxjerr nga feja dhe është shkak për qëndrim të përhershëm në zjarr nëse vdes pa u penduar. Ai është kryerja e një adhurimi për tjetërkënd pos Allahut, siç veprojnë disa njerëz duke iu lutur të tjerëve pos Allahut ose bëjnë kurban, luten dhe zotohen tek varret e “njerëzve të mirë”.
2. **Shirku i vogël**, i cili nuk të nxjerr nga Islami, porse pakëson teuhidin dhe është rrugë për tek shirku i madh.

Shirku i vogël ndahet në dy pjesë:

a. *Shirku i qartë* (i dukshëm), i cili bëhet me fjalë dhe vepra.

Tek shirku i vogël që bëhet me fjalë mund të përmendim:

- Betimin në diçka tjetër pos Allahut¹². Profeti thotë: *“Kush betohet në diçka tjetër pos Allahut ka bërë shirk”*.

- Thënia: *“Si të dëshirojë Allahu dhe ti”*. Dikush iu drejtua Profetit ﷺ duke i thënë: *“Si të dëshirojë Allahu dhe ti”*. Profeti ﷺ ia ktheu: *“A më bërë të barabartë me Allahun?! Thuaj: ‘Si të dëshirojë vetëm Allahu.’”*

- Thënia: *“Po të mos ishte Allahu dhe filani”*. E saktë është të themi: *“Po të mos ishte Allahu, pastaj filani”*.

Tek shirku i vogël, që bëhet me vepra, mund të përmendim: mbartjen e hajmalive, byzylykëve, fijeve të perit apo çfarëdolloj gjëje tjetër, me qëllim largimin e fatkeqësisë dhe mbrojtjes nga ajo.

¹² Siç betohen shumë njerëz, për kokën e fëmijëve ose të prindërve.

b. *Shirku i fshehtë*, i cili ndodh në qëllimet e njerëzve, kur njeriu vepron një adhurim me qëllim që ta lavdërojë njerëzit. Si p.sh.: dikush e zbukuron apo e zgjat namazin me qëllim që ta lavdërojë të tjerët, ose jep lëmoshë që të përmendet mes njerëzve se është bujar, apo e përmend Allahun me zë të lartë që ta dëgjojnë të tjerët e më pas ta lavdërojë.

❁ Si u përhap shirku në mesin e Muslimanëve ?

Arabët iu përmbajtën fesë së Ibrahimit, adhuronin një Zot të vetëm, derisa një person i quajtur Amr ibn Luhaj el Khizai ndërroi fenë e Ibrahimit duke sjellë disa idhuj në tokat arabe dhe Mekë në veçanti. Këta idhuj më pas i adhuruan pos Allahut, e kështu u përhap shirku në këto vende të shenjta dhe vendet përreth. Vazhdoi kështu derisa Allahu dërgoi vulën e Profetëve, Muhamedin ﷺ, i cili i ftoi njerëzit në adhurimin e Allahut, një dhe të vetëm, dhe në pasimin e fesë së Ibrahimit. Ai luftoi për Allahun me një luftë të vërtetë, gjersa u kthye besimi në teuhid dhe fenë e Ibrahimit, i theu idhujt dhe me të Allahu plotësoi fenë e Tij.

Gjeneratat e para të muslimanëve iu përmbajtën rrugës së Profetit ﷺ. Më pas, si pasojë e përhapjes së injorancës dhe infektimit nga kulturat dhe fetë e popujve të tjerë, u rishfaq sërish shirku në mesin e këtij ummeti me anë të thirrësve të devijuar dhe ndërtimeve mbi varre. Duke pretenduar dashuri për evliatë dhe njerëzit e mirë, u ndërtuan tyrbe mbi varret e tyre.

Kështu filloi të përhapej dukuria e adhurimit të varreve duke iu lutur, kërkuar ndihmë, betuar e bërë kurban për ta. Më e keqja ishte se këtë nuk e quajtën adhurim të këtyre njerëzve, pra shirk, por kërkim ndërmjetësimi prej tyre dhe në shenjë dashurie ndaj tyre, duke harruar se edhe idhujtarët e kohës së Profetit ﷺ vepronin të njëjtën gjë kur thoshin: **“Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu.”**¹³

Duhet të theksojmë se ata që i bëjnë ortak Allahut në adhurim besojnë se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Zotëruesi i çdo gjëje, porse kjo nuk ju bën dobi atyre.

I Lartësuari thotë: **“Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim.”**¹⁴

¹³ Kuran, Ez-Zumer: 3.

¹⁴ Kuran, Jusuf: 106.

Si ndodh mashtrimi?

Politeistët në origjinë ndahen në dy kategori:

1. **Populli i Nuhut;**
2. **Populli i Ibrahimit.**

Sa i përket popullit të Nuhut, origjina e devijimit dhe shirkut tek ata ishte qëndrimi tek varret e njerëzve të mirë, më pas iu ngritën atyre përmendore mbi varre¹⁵, e së fundmi, me kalimin e kohës, i adhuruan ata.

Ndërsa te populli i Ibrahimit origjina e shirkut ishte adhurimi i planetëve, Diellit dhe Hënës.

Realisht ata adhuronin xhinët¹⁶, pasi shejtani duke i mashtruar, u fliste atyre dhe i nxiste në gjëra të tilla. Ata mendonin se adhuronin engjëjt, ndërsa në të vërtetë adhuronin xhinët, pasi xhinët i nxisnin në shirk dhe ishin të kënaqur me këtë.

Allahu thotë: **“Ditën, kur do t’i tubojë të gjithë, do t’u thotë engjëjve: ‘Vallë, këta vetëm juve ju adhuronin?’ Ata do të thonë: ‘Qofsh i lavdëruar Ti, o Zoti ynë! Ti je mbrojtësi ynë, jo ata. Ata adhuronin xhinët dhe shumica e mohuesve u besonin atyre.”**¹⁷

¹⁵ Me qëllim përkujtimit e tyre.

¹⁶ Xhinët janë krijesa që Allahu i ka krijuar sikurse njerëzit dhe engjëjt.

¹⁷ Kuran, Sebe` : 40-41.

Engjëjt nuk nxisin në shirk dhe nuk kënaqen me diçka të tillë, porse janë shejtanët që cytin dhe personifikohen në forma njerëzore, duke iu shfaqur njerëzve e duke u thënë: *“Unë jam Ibrahim, Mesihu (Jezusi), Muhamedi, Khudejri, Ebu Bekri, Umeri, Uthmani, Aliu, unë jam sheh filani”*. Ndodh që t’i thonë njëri-tjetrit: *“Ky është Profeti filan”* ose *“Ky është Khudejri”*, në të vërtetë të gjithë ata janë xhinë, pra dëshmojnë për njëri-tjetrin.

Xhini është si njeriu, ka prej tyre jobesimtarë, mëkatarë, të shturur, ka adhurues injorantë, e disa të tjerë duan një sheh dhe personifikohen në formën e tyre dhe thonë: *“Unë jam sheh filani”*. Zakonisht kjo ndodh në shkretëtirë dhe vende të varfra. Më pas xhini i jep këtij njeriu ushqim për të ngrënë, i jep ujë për të hequr etjen ose i tregon rrugën, apo i tregon disa gjëra që kanë ndodhur në të kaluarën, e ky njeri mendon se shehu, i vdekur ose i gjallë, është ai i cili i bën këto gjëra dhe thotë: *“Ky është sekreti dhe fuqia e shehut, e ky është vetë shehu!”* ose thotë: *“Ky është engjëll në formën e shehut”*, ndërsa në realitet ai është xhin-shejtan, pasi engjëjt nuk nxisin në shirk, mashtrim, mëkat dhe armiqësi.¹⁸

¹⁸ "Mexhmua Fetawa, Ibn Tejmije".

❁ Kush janë evliatë

Pyetje: *Pyes rreth evliave në vendin tim dhe për tarikatet e tyre, kërkoj një sqarim nga hirësia juaj.*

Përgjigje: Evliatë janë besimtarët, ata janë Profetët dhe pasuesit e tyre. Janë ata të devotshmit, ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë pra evliatë, qofshin arabë apo të huaj, të bardhë apo të zinj, të pasur ose të varfër, sundimtarë apo të sunduar, këta janë evliatë.

Allahu thotë në Kuranin madhështor:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut (evliatë) nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillët janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut)”.¹⁹

Evliatë janë ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që frikësohen nga zemërimi i Tij duke i kryer obligimet dhe duke iu larguar atyre që ka ndaluar i Lartësuari.

Janë muslimanët e mirë, të udhëzuarit, njerëzit e besimit dhe devotshmërisë.

Ata nuk janë mashtruesit dhe pretenduesit e gjërave të jashtëzakonshme, në të cilat ndihmohen nga shejtanët, apo të mrekullive të rreme. Assesi! Përkundrazi, ata janë besimtarët, kanë ose jo mrekulli. Shumica e sahabëve

¹⁹ Kuran, Junus: 62-63.

(shokët e Profetit), Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, të cilët kanë qenë njerëzit më të devotshëm, njerëzit më të mirë pas Profetëve, evliatë e Allahut, nuk kishin mrekulli mbinatyrore, të jashtëzakonshme, pasi besimi i tyre ishte i fortë dhe nuk kishin nevojë për gjëra të tilla. Nuk është kusht që të bësh gjëra mbinatyrore, që dalin jashtë të zakonshmes për të qenë evlia, si p.sh.: të vijë ushqimi në mënyrë të paparë ndonjëherë, apo pasuria në mënyrë të panjohur dhe të ngjashme me këto. Jo! Shenja dhe kriteri i evliasë është devotshmëria dhe besimi në Allahun. Nëse është i devotshëm ndaj Allahut, u bindet urdhrave të Tij dhe u largohet ndalesave, pikërisht ai është evlia i Allahut.

❁ Vizita e tyrbeve dhe puthja e tyre

Pyetje: *A konsiderohet mëkat vizita e shehut apo dervishit nëse vizituesi puth dritaret dhe dyert e tyrbes apo varrin e shehut? Na këshilloni. Allahu ju shpërbleftë me të mira!*

Përgjigje: Vizita e varrezave është vepër e rekomanduar për burrat nëse është për qëllim që të luten për të vdekurin, e lutin Allahun që ta mëshirojë atë dhe kërkojnë falje për të, ashtu siç vepronte Profeti ﷺ. Shokët e Profetit ﷺ kur vizituan varret, Profeti ﷺ iu tha atyre: **“Vizitoni varrezat pasi ato ju përkujtojnë botën tjetër”**.

Vizita e varrezave ka dobi dhe vlerë të madhe, pasi njeriu përkujton botën tjetër, vdekjen, e lut Allahun që t'i falë dhe t'i mëshirojë të vdekurit. Kjo është vizita e ligjëruar islame.

Profeti ﷺ i mësonte shokët e tij që kur të vizitonin varrezat të thoshin:

“Es-selamu alejkum ehle dijari minel mu’minine uel muslimine ue inna insheAllahu bikum laahiku. Nes’elu Allah lena ue lekumul aafijete.”

Paqja e Allahut qoftë mbi ju! O banorët e këtij vendi, besimtarë e muslimanë! Edhe ne me urdhrin e Allahut, inn shaa Allahu me ju do të radhitemi. Lusim Allahun të na falë ne dhe ju.

Ndërsa në hadithin e Aishes thuhet: **“Jerhamu Allahu el-mustekdimine minna uel muste’khirine”**

Allahu i mëshiroftë të parët e të mbramët tanë.

Kjo është vizita e ligjëruar, por nëse i lutemi të vdekurit apo themi: *“Më shëro nga sëmundja apo ma largo këtë bela!”*, ky është shirk i madh. Kjo nuk lejohet, as me shehun, as me dervishin, as me Profetin ﷺ, apo kushdo qoftë.

Nuk lejohet t'i thuhet ndonjërit prej të vdekurve: *“Më ndihmo!”* apo *“Më shëro nga sëmundja! Ma kthe atë që më ka humbur! Unë jam pranë teje, jam nën llogarinë tënde, pra më fal mua!”*. Apo të themi: *“M'i largo këto telashe!”*. Të gjitha këto nuk lejohen në mënyrë kategorike.

Përkundrazi janë shirk i madh, pasi të gjitha janë cilësi të veçanta që i takojnë vetëm Allahut të Lartmadhëruar, të cilat nuk i posedon i vdekuri. Këto gjëra nuk kërkohen as nga i vdekuri, as nga idhulli, pema, xhini, engjëlli, porse kërkohen vetëm nga Allahu i Lartësuar. Kush i kërkon këto gjëra nga të vdekurit, ka bërë shirk të madh, për të cilin i ka paralajmëruar Allahu robërit e Tij, ka zbritur librat e shenjtë dhe ka dërguar Profetët me paralajmërimë, siç thotë Allahu:

“...Adhuroni vetëm Allahun, sepse unë (Muhamedi) jam për ju një lajmëruar dhe sjellës i lajmit të mirë prej Tij.”²⁰

“...prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut!”²¹

I Lartësuari thotë:

“Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar (që u thoshte): ‘Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!’”²²

Adhurimi është e drejtë ekskluzive që i përket Allahut dhe nuk i takon njeriut që të kërkohet shërim, heqje të telasheve nga të vdekurit apo idhujt, yjet, gurët, pemët, xhinët, engjëjt. Të gjitha këto janë shirk i madh.

²⁰ Kuran, Hud: 1-2.

²¹ Kuran, El-Xhin: 18.

²² Kuran, En-Nahl: 36.

Puthja e varrit apo dritareve, ose fërkimi tek varri, të gjitha këto nuk lejohen, ndërsa ai që qëndron tek varri, vetëm jep selam dhe asgjë më shumë, lutet për të vdekurin dhe kërkon mëshirë për të, ashtu siç e përmendëm.

Nuk lejohet ndërtimi mbi varre, as të kthehen në faltore, as të vendosen kupola (betoni e mermeri) mbi to. Profeti ﷺ ka thënë: ***“Allahu i mallkoftë çifutët dhe të krishterët që i shndërruan varrezat e Profetëve të tyre në faltore.”***²³ Gjithashtu ka thënë: ***“Ata që ishin para jush, i shndërruan varret e Profetëve të tyre në faltore, por ju mos i shndërroni varret në faltore, sepse unë ju ndaloj ta bëni këtë.”***²⁴

Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: ***“Ka ndaluar Profeti suvatimin e varreve, uljen dhe ndërtimin mbi to.”*** Pra, suvatimi i varreve, ndërtimi mbi to dhe shndërrimi i tyre në faltore, të gjitha këto janë të ndaluara dhe janë shkak që shpien në ekstremizëm ndaj tyre e më pas në adhurim të dikujt a diçkaje tjetër përveç Allahut. Vizituesi e ka për detyrë që të zbatojë ligjet fetare dhe të largohet nga gjërat që ia ka ndaluar Allahu.

²³ Sahih, transmeton Buhariu (1390) dhe Muslimi (529) nga hadithi i Aishes.

²⁴ Sahih, e ka nxjerrë Muslimi (532), shiko tek "Iruau el Gelil" 286, nga hadithi i Xhundub bin Abdilah.

Gjithashtu, ulja tek varret për t'iu lutur Allahut apo për të falur namaz tek varri nuk lejohet. Secili prej nesh obligohet që të paralajmërojë rreth këtyre veprimeve të ndaluara, pasi është rrugë drejt shirkut. Ta lutësh të vdekurin, të kërkosh mbështetje, shërim nga ai, është shirk i madh. Bërja e duasë dhe falja e namazit tek varri është bidat dhe rrugë për në shirk. E njëjta gjë është edhe për ndërtimin mbi varre dhe vendosjen e kupolave, këto janë bidate, të cilat janë rrugë për në shirk.

Muslimanët obligohen që të largohen e të shmangen nga gjëra të tilla dhe ta kthejnë varrin ashtu siç ka qenë në fillim, të rrëzojnë çdo gjë që është ndërtuar mbi të, qoftë ajo tyrbe, faltore apo kupolë, ashtu siç ishin varret në kohën e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij, kur mbi to nuk kishte as tyrbe e as kupolë apo diçka tjetër. Kjo është sipas fesë islame, e kështu jemi të obliguar t'i kemi varret. E lusim Allahun që të na falë ne dhe të gjithë muslimanët!

❁ **Shkuarja tek varret e “të shenjtëve” kur jemi sëmurë dhe të kërkuarit ndihmë prej tyre.**

Pyetje: *Kur janë në situata të vështira njerëzit thonë:*

“O i Dërguari i Allahut!” ose “O evlia filani” dhe shkojnë tek varret e “të shenjtëve” kur janë të sëmurë dhe kërkojnë ndihmë prej tyre dhe thonë: “Allahu e largon të keqen me anë të tyre. Ne i lusim ata porse qëllimi ynë është Allahu, pasi vetëm Ai jep rezultat, Ai bën dobi”. A është ky shirk? A konsiderohen këta politeistë? Gjendja e tyre është se ata falen, lexojnë Kuran dhe veprojnë punë të mira.

Përgjigje: Ajo që veprojnë ata është si shirku që bënin pasuesit e injorancës (Ehlul xhahilije). Ata lusnin Latin, Uzanë, Menatin²⁵ dhe të tjerë. Kërkonin ndihmë prej tyre, i madhëronin ata dhe shpresonin që ata t’i afronin tek Allahu, sakaq thoshin: **“Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu”**²⁶, gjithashtu thoshin: **“Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu!”**²⁷

Na ka sqaruar Profeti ﷺ se duaja (lutja) është adhurim dhe ajo duhet t’i drejtohet vetëm Allahut, po ashtu Allahu

²⁵ Emra idhujsh.

²⁶ Kuran, Ez-Zumer: 3.

²⁷ Kuran, Junus: 18.

e ka ndaluar që dua ja t'i dedikohet dikujt tjetër pos Tij. I Lartmadhëruari ka thënë: **“Përveç Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellë as dobi, as dëm. Nëse do ta bëje këtë, atëherë ti do të ishe vërtet keqbërës. Nëse Allahu vendos që të të godasë ndonjë e keqe askush nuk mund të ta largojë atë, përveç Tij e, nëse Ai do të të bëjë ndonjë të mirë, e s'ka kush që ta pengojë mirësinë e Tij. Ai ia jep atë mirësi kujt të dojë prej robërve të Vet. Ai është Falës dhe Mëshirëplotë.”**²⁸

Përkundrazi muslimanët thonë: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!”**²⁹ në çdo rekat të namazit të tyre, duke nxjerrë në pah se adhurimi duhet të jetë vetëm për Allahun, gjithashtu dhe ndihma duhet të kërkohet vetëm nga Ai dhe jo nga të vdekurit prej Profetëve apo të shenjtëve. Mos t'ju mashtrojë namazi i shumtë që bëjnë ata, agjërimi dhe leximi i tyre, me të vërtetë ata janë prej atyre që kanë humbur në këtë botë.

²⁸ Kuran, Junus: 106-107.

²⁹ Kuran, El-Fatiha: 5.

❁ Therja e kurbaneve tek tyrbet

Pyetje: Është një tyrbe e evliave, në të cilën theren çdo vit ditën e Ashures mbi 40 desh dhe dele dhe afërsisht 10 lopë. Aty mbliidhen disa muslimanë mendjelehtë, lexojnë Kuran për të vdekurit e më pas hanë nga kurbanet që kanë therur. Kërkojmë nga shkëlqesia juaj të na sqaroni rreth këtij problemi me argumentet përkatëse.

Përgjigje: Së pari, ajo që përmendët, therja e kurbaneve tek tyrbet e evliave, është shirk. Vepruesi i saj është i mallkuar pasi ai ther kurban për tjetërkënd pos Allahut. Është saktësuar nga Profeti ﷺ se ka thënë: *"E mallkoftë Allahu atë i cili ther për tjetërkënd përveç Allahut"*. Si rrjedhojë nuk lejohet të hahet prej mishit të deleve apo lopëve, të cilat janë therur tek varret e evliave.

Së dyti, leximi i Kuranit për të vdekurit është bidat i shpikur. Profeti ﷺ ka thënë: *"Kush shpik në çështjen (fenë) tonë atë që nuk është prej saj, ajo gjë është e refuzuar."*

❁ Shkuarja e gruas tek tyrbet (varret) me qëllim shtatzëninë

Pyetje: Në vendin që unë jetoj gruaja që nuk mbetet shtatzënë pas disa muajsh martese dërgohet tek tyrbet (varrezat), ose e çojnë në vende në të cilat duhet të bëjnë kurban një lopë në mënyrë që të mbetet shtatzënë. Cili është gjykimi i Islamit?

Përgjigje: Nuk lejohet që të dërgohet gruaja që nuk mbetet shtatzënë tek tyrbet (varret) me qëllim kërkimin e shtatzënisë, pasi kjo është lutje që u drejtohet të vdekurve dhe kërkimi i ndihmës prej tyre që t'i zgjidhin problemet është shirk i madh dhe besim i kotë, përkundrazi Ai që lutet për furnizimin me fëmijë, apo ndonjë nevojë tjetër, është Allahu një i vetëm, i pa shok. Thotë Allahu: “ **Zoti juaj thotë: ‘Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!’**”³⁰. Gjithashtu thotë i Lartmadhëruari: “**...prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut!**”³¹

Po ashtu nuk lejohet bërja kurban një lopë me qëllim kërkimin e shtatzënisë, pasi ky është kurban për të tjerë pos Allahut, e ky është shirk i madh nëse ka për qëllim me të afrim tek xhini apo dikë tjetër nga krijesat, ose bidat (shpikje në fe) nëse e bën këtë kurban për Allahun

³⁰ Kuran, Gafir: 60.

³¹ Kuran, El-Xhin: 18.

dhe ka për qëllim kërkimin e shtatzënisë. Nga çdo lloj këndvështrimi kjo nuk lejohet dhe është obligim pendimi tek Allahu nga një gjë e tillë dhe personi të mos kthehet tek e njëjta vepër, obligohet ndalesa dhe paralajmërimi i kësaj vepre.

Allahu e jep suksesin dhe Allahu dërgoftë bekime dhe përshëndetje mbi Profetin tonë Muhamed ﷺ, mbi familjen dhe shokët e tij.

❁ **Të kërkuarit ndihmë prej varreve të evliave, betimi në ta dhe marrja e tyre si ndërmjetësues për tek Allahu.**

Pyetje: Çfarë gjykimi ka në Islam rreth të kërkuarit ndihmë prej varreve të evliave, rrotullimi rreth tyre, kërkimi i bereqetit prej gurëve të varrit, betimi në to, ndërtimi mbi to dhe marrja e tyre si ndërmjetësues tek Allahu?

Përgjigje: Kërkimi i ndihmës prej varreve të evliave, betimi në to dhe lutja e tyre, që ata të jenë ndërmjetësues tek Allahu, është shirk i madh që të nxjerr nga feja islame. Vendqëndrimi i atij që vepron si më lart është zjarri, nëse vdes në këtë gjendje. Ndërsa tavafi rreth varreve dhe ndërtimi mbi to është bidat dhe rrugë e rrezikshme që

shpie në adhurimin e tyre, në vend të adhurimit vetëm të Allahut. Ndërsa është shirk nëse pretendon se i vdekuri i bën atij dobi dhe i largon dëmin, ose ka për qëllim me tavafin afrimin me të vdekurin.

Allahu e jep suksesin. Allahu dërgoftë bekime dhe përshëndetje mbi Profetin tonë Muhamed ﷺ, mbi familjen dhe shokët e tij.

Përfundim ³²

Siç u sqarua më lart, rruga e vetme e ligjëruar për zgjidhjen e këtyre halleve është kthimi tek Allahu, duke iu lutur vetëm Atij, pasi dobia, mbrojtja, shërimi dhe bereqeti janë në dorën e Tij.

“Zoti juaj thotë: Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!”³³

O rob i Allahut! Mos e shkatërro besimin tënd duke iu lutur të vdekurve, pasi ata nuk kanë mundësi të të ndihmojnë.

Vallë, a thua ka mundësi ai që ti po i lutesh, t’i bëjë dobi vetes së tij? Kurrsesi! Përkundrazi, ai ka nevojë që ti të lutesh për të.

Mos ua vër veshin atyre që thonë: *“Filani u shërua. Vendi i mirë i bëri derman”*, e kështu me radhë. Këto janë mashtrime të shejtanit për t’i dërguar njerëzit në shirk, që t’u luten të tjerëve pos Allahut.

E lusim Allahun që të na bëjë dobi kjo që lexuam!

³² Përkthyesi.

³³ Kuran, Gafir: 60.

Përmbajtja:

Parathënie	3
Devijimi i njerëzve	5
Shirku dhe llojet e tij	7
Si u përhap shirku në mesin e Muslimanëve ?	10
Si ndodh mashtrimi?.....	12
Kush janë evliatë	14
Shkuarja tek varret e “të shenjtëve” kur jemi sëmurë dhe të kërkuarit ndihmë prej tyre.....	20
Therja e kurbaneve tek tyrbet.....	22
Shkuarja e gruas tek tyrbet (varret) me qëllim shtatzëninë.....	23
Të kërkuarit ndihmë prej varreve të evliave, betimi në ta dhe marrja e tyre si ndërmjetësues për tek Allahu.	24
Përfundim	26

